UDHËZIM
Nr. 9, datë 5.10.2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 27.6.2022, "PËR KUALIFIKIMIN E VAZHDUAR PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS PROFESIONALE NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të pikës 1, të nenit 70, të udhëzimit nr. 759, datë 30.9.2024, të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 21, datë 27.6.2022, "Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2 të nenit 4, fjala "pranohen" zëvendësohet me fjalët "u nënshtrohen detyrimisht".

2. Në pikën 1 të nenit 8, pas fjalëve "publikuar në faqen zyrtare të AKAFPK-së" shtohen fjalët "dhe/ose në portalin e Kualifikimit të Vazhduar Profesional (KVP)".

3. Në pikën 4 të nenit 8, pas fjalëve "në adresën përkatëse të AKAFPK-së" shtohen fjalët "dhe/ose në portalin e KVP-së".

4. Në pikën 6 të nenit 8, fjalët "10 ditëve pune" zëvendësohen me fjalët "15 ditëve pune".

5. Në pikën 7 të nenit 8, pas fjalëve "njofton me *email* aplikuesin" shtohen fjalët "dhe/ose publikon njoftimin në portalin e KVP-së".

6. Në nenin 8, pas pikës 16 shtohet pika 17 me këtë përmbajtje:

"17. Në rast të mosfunksionimit të portalit të KVP-së, dokumentacioni i aplikimit dërgohet me postë në adresën zyrtare të AKAFPK-së.".

7. Në nenin 9, pas pikës 10 shtohen pikat 11 dhe 12 me këtë përmbajtje:

"11. AKAFPK-ja ofron trajnime të akredituara për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP, për risitë në fushën e AFP-së, në përputhje me standardin e mësimdhënësit të kulturës profesionale në AFP dhe programet përkatëse të kualifikimit.

12. Kreditet e trajnimeve që zhvillohen nga AKAFPK-ja përcaktohen nga KKM-ja, sipas rregullave për akreditimin e ofruesve të trajnimeve.".

8. Pika 4 e nenit 14/1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

"4. Në rast se koordinatori i ZHVP-së ose anëtarët e tjerë të komisionit janë kandidatë për kualifikim dhe duhet të realizojnë vetë seancën mësimore të hapur, ata nuk mund të jenë anëtarë të komisionit të vlerësimit.".

9. Në pikën 5 të nenit 14/1, pas fjalëve përkatëse që përcaktojnë anëtarin e komisionit, shtohen fjalët "dhe që zotëron kategorinë më të lartë të kualifikimit në shkollë, me vlerësimin të paktën 'Shumë mirë'".

10. Pika 3 e nenit 15 shfuqizohet.

11. Pika 3 e nenit 15/1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

"3. Kandidati që realizon seancën mësimore të hapur mund të vlerësohet maksimalisht me 50 pikë nga kryetari dhe secili anëtar i komisionit. Rezultati përfundimtar i këtij vlerësimi llogaritet si

mesatare aritmetike e ponderuar e vlerësimeve të komisionit, në raportin 40 për qind për kryetarin dhe 20 për qind për secilin anëtar. Nëse kryetari i komisionit konstaton vlerësime dukshëm të kundërta nga anëtarët e komisionit, ka të drejtë të kërkojë diskutimin dhe rivlerësimin e kandidatit për kategorinë 'Mësues mjeshtër'."

12. Në pikën 1 të nenit 16, fjalët "2023 e në vijim" zëvendësohen me fjalët "2027 e në vijim".

13. Në pikën 2 të nenit 16, fjalët "për vitin 2022" zëvendësohen me fjalët "për vitin 2027 e në vijim".

14. Në tabelën 1 të shtojcës 2 bëhen këto ndryshime:

a) në rreshtin e parë, në kolonën "Kriteret e vlerësimit", pas fjalës "Përmbajtjet" shtohen fjalët "ose veprimtaritë mësimore";

b) rreshti i dytë, në kolonën "Elementi i portofolit", ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Plan-ditar i një seance teorike me prani fizike dhe *online* ose praktike me prani fizike";

c) rreshti i tretë, në kolonën "Kriteret e vlerësimit", ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Objektivi në koherencë me përmbajtjen mësimore";

ç) rreshti i katërt, në kolonën "Elementi i portofolit", ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Test teorik (jo më pak se 5 njësi) ose listë kontrolli për një aftësi praktike (jo më pak se 5 kritere vlerësimi)";

d) rreshti i katërt, në kolonën "Kriteret e vlerësimit", ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Testi me të paktën 5 njësi/lista e kontrollit me të paktën 5 kritere";

dh) rreshti i pestë, në kolonën "Kriteret e vlerësimit", pas fjalëve "Përmbajtja e materialit mësimor/përmbajtja e udhëzuesit" shtohen fjalët ""në përputhje me planin e mësimdhënies së lëndës/modulit";

e) rreshti i shtatë, në kolonën "Elementi i portofolit", ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Trajnime të akredituara shtesë ose trajnime të paakredituara, të kryera gjatë tre viteve të fundit të mësimdhënies";

ë) rreshti i shtatë, në kolonën "Kriteret e vlerësimit", fjalët "6–30 orë" zëvendësohen me fjalët "19–30 orë".

15. Në tabelën 2 të shtojcës 2 bëhen këto ndryshime:

a) në rreshtin e tretë, në kolonën "Pikët për çdo kriter", numri "4" zëvendësohet me numrin "2";

b) në rreshtin e tretë, në kolonën "Pikët maksimale", numri "4" zëvendësohet me numrin "2".

16. Në shtojcën 3, fjalët "Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë" zëvendësohen me fjalët "ministrisë përgjegjëse për AFP-në".

17. Në shtojcën 4, fjalët "MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË" zëvendësohen me fjalët "MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT".

18. Në shtojcën 5 bëhen këto ndryshime:

a) rreshti i tretë, i kolonës së parë, ndryshon nga "50 ÷ 65" në "50 ÷ 63";

b) rreshti i katërt, i kolonës së parë, ndryshon nga "66 ÷ 78" në "64 ÷ 77";

c) rreshti i pestë, i kolonës së parë, ndryshon nga "79 ÷ 90" në "78 ÷ 90";

19. Shtojca 6 zëvendësohet me shtojcën 6, "Instrumenti i vlerësimit të kandidatit për kategorinë e kualifikimit 'Mësues mjeshtër', nëpërmjet seancës mësimore të hapur", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, ofruesit e AFP-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

SHTOJCA 6

INSTRUMENTI I VLERËSIMIT TË KANDIDATIT

për kategorinë e kualifikimit "Mësues mjeshtër", nëpërmjet seancës mësimore të hapur

Shkolla: ..... Mësimdhënësi kandidat: .....

Nr.	Fushat e vlerësimit	Kriteret	Pikët gjithsej	Pikët e fituara
1	**Parapërgatitja e seancës mësimore (10 pikë)**	Harton dokumentin planifikues të mësimit.	2 pikë	
		Planifikon në përputhje me planin e mësimdhënies së lëndës/modulit.	2 pikë	
		Siguron paraprakisht mjetet dhe materialet e nevojshme.	2 pikë	
		Përgatit paraprakisht materialet mbështetëse dhe ilustruese në mbështetje të përmbajtjes dhe në cilësinë e duhur.	2 pikë	
		Organizon siç duhet mjedisin dhe mjetet e mësimit, dhe krijon kushte të përshtatshme për realizimin e tij.	2 pikë	
2	**Aftësitë e buta dhe të tranzicionit të dyfishtë (të gjelbër dhe digjital) (6 pikë)**	Përdor siç duhet komunikimin verbal dhe joverbal me nxënësit.	2 pikë	
		Krijon klimë pozitive ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	2 pikë	
		Zbaton parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes, diversitetit, si dhe mënyrat e integrimit të aftësive të tranzicionit të dyfishtë (të gjelbër dhe digjital) në procesin mësimor.	1 pikë	
		Nxit etikën, komunikimin efektiv dhe veprimtaritë socio-emocionale në mjedisin mësimor.	1 pikë	
3	**Realizimi i seancës mësimore (20 pikë)**	Zbaton fazat e mësimit sipas planifikimit të bërë.	5 pikë	
		Përdor metodat mësimore të duhura për përmbajtjen e seancës mësimore.	5 pikë	
		Përdor medie mësimore/materiale ilustruese, në përputhje me përmbajtjet e mësimit.	5 pikë	
		Motivon dhe aktivizon sa dhe si duhet nxënësit.	5 pikë	
4	**Vlerësimi i nxënësve (8 pikë)**	Vlerëson për të identifikuar nevojat e nxënësve për përmirësim.	3 pikë	
		Përdor teknikat e duhura për vlerësimin e vazhduar të nxënësve gjatë procesit mësimor.	3 pikë	
		Përdor instrumentet e duhura për vlerësimin e rezultatit të të nxënit të nxënësve.	2 pikë	
5	**Mjedisi dhe mjetet mësimore (6 pikë)**	Krijon mjedis të sigurt dhe me kushte të përshtatshme (hapësirë, temperaturë, ndriçim) për realizimin e seancës mësimore.	2 pikë	
		Përdor mjetet digjitale, për të zhvilluar aftësitë digjitale dhe për të nxitur të nxënit digjital të tyre.	2 pikë	
		Sistemon mjedisin pas përfundimit të mësimit.	2 pikë	
		Vlerësimi i përgjithshëm	**50 pikë**	

Komisioni i vlerësimit

Përfaqësues i trajnerëve (Kryetari) (emër, mbiemër, firma)

Koordinatori i ZHVP (anëtar) (emër, mbiemër, firma)

Mësimdhënës i shkollës (anëtar) (emër, mbiemër, firma)

Mësimdhënës i një shkolle tjetër (anëtar) (emër, mbiemër, firma)

Data .....